



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Nr. Dik. Org./Jehonice Org./Unit	SP-02
Nr. Prot. Breg./Prot. Prot. No.	5429-2/18
Nr. i faqesve Breg./Stranica No pages	03
Data: Datum: Date:	03.10.19
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	03.10.2019
<b>REFERENC-Ë:</b>	18/5429/685/DMMU
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"Euroasphalt" Sh.p.k. Gjakovë Bazë e asfaltit dhe betonit në Mramull- Gjakovë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për Leje Mjedisore



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "Euroasphalt" Sh.p.k. Gjakovë, me nr. prot. 18/5429/685/DMMU, të datës: 21.09.2018.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë "Euroasphalt" Sh.p.k. Gjakovë, bazë e asfaltit dhe betonit në Mramull- Gjakovë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

**V E N D I M**

**Leje Mjedisore**

Kompanisë "Euroasphalt" Sh.p.k. Gjakovë, bazë e asfaltit dhe betonit në Mramull- Gjakovë.

**A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe shqyrtimit të informatave shtesë për kompaninë "Euroasphalt" Sh.p.k. Gjakovë, për bazën e asfaltit dhe betonit në ngastrën kadastrale nr. P- 70705048 - 01205-2, nr. 01206-0, nr. 01224-3, nr. 01207-2, nr. 01220-2, nr. 01207-1, nr. 01220-1, zona kadastrale Mramull- Gjakovë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për leshuarjen e Lejes Mjedisore.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike, vlerat kufitare të emisioneve, cilësisë së ajrit, dhe ujërave shkarkuese të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Raporti i rezultateve të monitorimit për vlerat kufitare të emisioneve, cilësisë së ajrit dhe ujërave shkarkuese, sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPH-s;
- Kontejnerët me aditiv ti mbajë në vend të betonuar dhe izoluar;

Faqe 2 nga 3



- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPH;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 18/5429/ZSP/476/19 datë: 03.10.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së

